



VENDIM

Nr.59 Datë 19.08.2009

**PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LIÇENSIMIN NE
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE TE
SHOQËRISË “TEODORI 2003” SH.P.K.**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, gërma “a”, 9 dhe 13 pika 1, gërma a, të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma a, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, nenit 18, pika 1, gërma a, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, date 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 19.08.2009, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “TEODORI 2003” sh.p.k., për t`u liçensuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

dhe konstatoi:

- Paraqitjen e aplikimit konform përcaktimeve të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për liçensimin e shoqërisë “TEODORI 2003” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE-s

Bujar Nepravishta

Ne mungese dhe me porosi

z. Ardian Haçi



REPUBLIKA E SHQIPERISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Bordi i Komisionerëve



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr.59 Datë 19.08.2009

PËR
FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR LIÇENSIMIN NE
AKTIVTETIN E PRODHIMIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE TE
SHOQËRISË “TEODORI 2003” SH.P.K.

Anëtarët e Bordit

| | Pro | Kundër |
|--------------------------|-------|--------|
| Bujar Nepravishta | _____ | _____ |
| Entela Shehaj | _____ | _____ |
| Ardian Haçi | _____ | _____ |
| Abaz Aliko | _____ | _____ |
| Shkëlqim Bozgo | _____ | _____ |